

**Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë  
MISSIONI NË KOSOVË**

**Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës  
Seksioni i monitorimit të sistemit juridik**

**Raport mbi lëndën:**

**Zyra e Prokurorisë Publike  
kundër**

**Latif Gashit, Rrustem Mustafës, Naim Kadriut dhe Nazif Mehmetit**

**Lënda “Grupi i Llapit”**

## 1. Hyrje:

Ky raport mbi lëndën, ka të bëjë me procesin gjyqësor kundër Latif Gashit, Rustem Mustafës, Naim Kadriut dhe Nazif Mehmetit, përndryshe i njohur si “gjykimi i grupit të Llapit”. Ky raport është përpiluar nga OSBE-ja, konkretisht nga Seksioni për monitorim të sistemit juridik në kuadër të Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundimit të së drejtës. Lëshohet pas dorëzimit të aktgjykimit me shkrim të datës 16 dhjetor 2003. Secila palë kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrojë ankesë pranë Gjykatës Supreme.

Seksionit për monitorim të sistemit juridik, i është dhënë detyra e monitorimit të lëndëve të gjykatave penale, duke vlerësuar përshtatshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare, dhe duke raportuar mbi aspektet shqetësuese në këtë drejtim. Seksioni për monitorim të sistemit juridik i ka përcjellur të gjitha lëndët e krimeve të luftës të gjykuara në Kosovë. Një analizë më të hollësishme të këtyre lëndëve mund ta gjeni në raportin e titulluar “*Gjykimet e krimeve të luftës në Kosovë: Shqyrtim*” që është publikuar gjatë shtatorit të vitit 2002 dhe gjindet në faqen e internetit të OSBE-së.<sup>1</sup>

Seksioni për monitorimin e sistemit juridik, në pajtim me mandatin që e ka, e ka përcjellë rastin “grupi i Llapit” për aq sa ka zgjatur. Analiza e procedurës së zhvilluar përshkruhet në tekstin në vazhdim. Është me rëndësi të bëhet me dije se ky gjykim është monitoruar për qëllim të vlerësimit nëse ka pasur, ose nuk ka pasur, çështje shqetësuese në lidhje me korrektësinë e procedurës (ose shqetësime tjera nga aspekti i sundimit të së drejtës). Këto çështje janë më shumë të natyrës procedurale. Seksioni për monitorimin e sistemit juridik përmes këtij raporti *nuk* e ka për qëllim të komentojë ose vërtetojë konkluzionet substanciale të gjykatës.

## 2. Përmbledhje e lëndës “grupi i llapit”:

Ky rast ishte njëri prej proceseve më të rëndësishme gjyqësore të mbajtur në Kosovë në të cilin akuzoheshin shqiptarët e Kosovës dhe paditeshin për krime lufte, me ç’rast edhe është përcjellur me vëmendje të konsiderueshme nga opinioni publik. Kundër të akuzuarve ishte ngritur aktakuza për krime lufte, duke u bazuar në ligjin vendës në fuqi, për kryerjen e veprave kundër viktimave, kryesisht, shqiptare të Kosovës; e që prej gjithsej 26 viktimave të numëruara në aktakuzë, njëra prej tyre ka qenë e serb i Kosovës.

Seanca e parë gjyqësore fillimisht ishte mbajtur me 17 shkurt 2003, në zyret e ndërtesës së Këshillit Britanik në Prishtinë/Pristina. Për shkak të interesimit të opinionit publik të cilin e zgjoi ky rast, dhe për shkak të çështjeve të sigurisë që ndërlidheshin me të, mbajtja e gjyqimit kishte kaluar në një vend më të gjërë, me kapacitet prej përafërsisht 200 ulësve për njerëz. Të gjithë pjesëmarrësve në gjykim, por edhe pjesëmarrësve në publikë, u janë shpërndarë pajisjet për përkthim simultan për dëgjimin e procedurës në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Katër të akuzuarit: Latif Gashi, Rustem Mustafa, Naim Kadriu dhe Nazif Mehmeti, akuzoheshin për pjesëmarrje në heqje të paligjshme të lirisë, torturë dhe vrasje të civilëve prej gushtit 1998 deri në qershor 1999. Gjatë asaj kohe, të akuzuarit ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) që vepronin në Zonën Operative të Llapit; një zonë gjeografike prej përafërsisht 50 kilometra katrorësh dhe që gjindej në afërsi të qytetit të Podujevës/Podujevo në anën veriore të qendrës së Kosovës. Në atë zonë, gjindeshin pesë qendra burgimi në të cilat dyshohet se burgoseshin civilët:

<sup>1</sup> <http://www.osce.org/kosovo/documents/reports/>

- Qendra e burgimit në Bajgorë/Bajgora: që ka funksionuar në periudhën prej gushtit 1998 dhe shtatorit/tetorit 1998;
- Qendra e burgimit në Llapashticë/Lapaštica: që ka funksionuar në periudhën prej nëntorit 1998 dhe marsit 1999;
- Qendra e burgimit në Majac/Majance: që ka funksionuar në periudhën prej marsit 1999 dhe prillit 1999;
- Qendra e burgimit në Potok: që ka funksionuar në periudhën prej marsit 1999 dhe prillit 1999;
- Qendra e burgimit në Koliq/Količ: që ka funksionuar në periudhën prej majit 1999 dhe qershorit 1999.

Të akuzuarit ngarkoheshin për veprimet e përbashkëta me rojet tjera të paidentifikuara dhe pjesëtarët e UÇK-së, se në mënyrë joligjore i kanë burgosur civilët ose përmes arrestimit të kundërligjshëm ose për thirrjen në “biseda informative” të personave. Sipas aktakuzës, të burgosurit akuzoheshin se kanë bashkëpunuar me forcat serbe, me të cilat UÇK-ja luftonte në atë kohë. Aktakuza më tej, pohonte se të burgosurit ishin mbajtur në kushte johumane; u ishin mohuar kushtet higjienike, ushqimi, uji dhe kujdesi shëndetësor; u ishin nënshtruar të rrahurave dhe torturave rutinore, ishin detyruar ta rrihnin njëri tjetrin, ishin detyruar në pranim të rrejshëm të fajit dhe kërcënuar me vdekje.

### 3. Përfundimet e gjyqit:

Gjykimi ka filluar me 20 shkurt 2003 (pas dy ditë seancash dëgjimore në procedurë paraprake). Gjithsejt janë mbajtur 54 ditë gjykim në seancat e të cilave janë dëgjuar 45 dëshmitarë. Kryetari ndërkombëtar i trupit gjykues e ka shpallur të përfunduar procesin gjyqësor të hënën me 14 korrik 2003 dhe e ka shpallur gojarisht aktgjykimin të mërkurën me 16 korrik 2003. Në aktgjykimin e shruar të datës 11 nëntor 2003 (dhe të dorëzuar pas përkthimit të tij me 16 dhjetor 2003), gjykata i ka përmbledhur përfundimet e veta në lidhje me fajësinë e personave të akuzuar si në vijim:

“Në pajtim me nenin 351 të Ligjit të Procedurës Penale (LPP) kundër secilit prej të akuzuarve të mëposhtëm janë provuar veprat e mëposhtme.

**NDAJ LATIF GASHIT**, i quajtur ndryshe komandant ‘Lata,’ kombësia shqiptar i Kosovës, emri i të atit Riza, emri i nënës Raba, i lindur në datën 12.09.61, vendlindja fshati Dobërdol, Komuna e Podujevës, i martuar, ka tre fëmijë, i diplomuar në Fakultetin e drejtësisë, drejtor i Shërbimit Informativ të Kosovës dhe oficer në rezervë në TMK nuk ka qenë i dënuar më parë ose procedura të tjera penale ndaj tij, jeton në qendrën e qytetit të Prishtinës në sheshin Nënë Tereza, në kordinatën gjeografike EN 1328 2333, në paraburgim që nga 28 janari 2002;

Gjatë periudhës 30 tetor 1998 deri në fund të prillit 1999, në bashkëpunim me Rrustem Mustafën dhe i ndihmuar e përkrahur nga Nazif Mehmeti dhe të tjerët, dhe nëpërmjet një plani të përbashkët kriminal, iu ka hequr lirinë në mënyrë të paligjshme qytetarëve shqiptarë të Kosovës që dyshoheshin si bashkëpunëtorë të serbëve në një qendër burgimi që ishte organizuar dhe kontrolluaj nga UÇK në Llapashticë si edhe në Majac dhe Potok, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore, duke i privuar ata nga kushtet sanitare të nevojshme, duke i rrahur dhe torturuar, duke ju shkakuar në këtë mënyrë vuajtje të mëdha dhe dhunim të shëndetit të tyre, dhe duke ua mohuar atyre të drejtën për një gjykim të drejtë; qytetarët, të cilëve u është hequr në mënyrë të paligjshme liria përfshinin; dëshmitarët 7, 4, Drita Bunjakun, Agim Musliun, Idriz Svarqën, Alush Kastatin, Hetem Jasharin, dhe dëshmitarin “V”, duke patur si qëllim të planit të tyre që të detyronin personat e burgosur që të praninin tradhëtitë ndaj UÇK-së dhe të ndëshkonin ata që ishin burgosur për ato tradhëti të dyshuara nga UÇK. (pika 2, 5 dhe 8).

Gjatë periudhës 31 maj 1999 deri në një datë të panjohur në mes të qershorit, në një lokacion të panjohur në Koliq, në bashkëpunim me Naim Kadriun, ai i ka hequr lirinë në mënyrë të paligjshme, ka rrahur dhe torturuar dëshmitarët “Q” dhe “R” duke iu shkaktuar atyre vuajtje të rëndë dhe dhunim të shëndetit trupor duke iu mohuar atyre të drejtën për një gjykim të drejtë (pika 3 dhe 9).

Gjatë periudhës 1 gusht 1998 deri në 26 shtator 1998, një qendër paraburgimi e organizuar dhe nën kontrollin e UÇK-së në Bajgorë, ai e ka rrahur dhe torturuar Milan Stankovicin duke iu shkaktuar atij vuajtje të rëndë dhe dhunim të shëndetit trupor dhe duke ndihmuar dhe përkrahur heqjen e paligjshme të lirisë së Milovan Stankovicit. (pika 12 dhe 14).

Në lidhje me Latif Gashin, veprat e mëposhtme nuk janë vërtetuar:

- Pika 1 – Dyshimi në lidhje me heqjen e paligjshme të lirisë (ndaj viktimave shqiptare të Kosovës) në Bajgorë;
- Pika 4 – Dyshimi për trajtimin çnjerëzor (ndaj viktimave shqiptare) në Bajgorë;
- Pika 5 (pjesërisht) – Dyshimet për trajtimin çnjerëzor vetëm në Majac dhe Potok ;
- Pika 6 – Dyshimi në lidhje me trajtimin çnjerëzor në Koliq;
- Pika 7 – Dyshimi në lidhje me rrahjen dhe torturën në Bajgorë;
- Pika 8 (pjesërisht) – Dyshimet në lidhje me rrahjet dhe torturat vetëm në Majac dhe Potok;
- Pika 10 – Dyshimi për vrasjen e viktimës 1, Osman Sinani;
- Pika 11 – Dyshimi në lidhje me vrasjen e Drita Bunjakut, Agim Musliut, Idriz Svarqës, Alush Kastratit, and Hetem Jasharit;
- Pika 13 – Dyshimi në lidhje me trajtimin çnjerëzor (Stankoviç) në Bajgorë.

**NDAJ NAZIF MEHMETIT**, i quajtur ndryshe “Dini” më kombësi shqiptar i Kosovës, i lindur me 20.09.61, emri i babait Hajdredin, emri i nënës Shahe, i martuar, ka tre fëmijë, vendlindja Shajkofc në Komunën e Podujevës, ka kryer Fakultetin e Drejtësisë në Prishtinë, banon në fshatin Shajkofc/Prishtinë, SU 3/2, kati i dytë #9, Prishtinë, i punësuar si polic në SHPK në Prishtinë, Stacioni 3, nuk ka dënime të mëparshme ose procedura të tjera penale në zhvillim e sipër; ndodhet në paraburgim që nga 28 janari 2002;

Gjatë periudhës 30 tetor 1998 deri në fund të prillit 1999, në bashkëpunim me Rustem Mustafën dhe i ndihmuar e përkrahur nga Latif Gashi dhe të tjerët, dhe nëpërmjet një plani të përbashkët kriminal, iu ka hequr lirinë në mënyrë të paligjshme qytetarëve shqiptarë të Kosovës që dyshoheshin si bashkëpunëtorë të serbëve në një qendër burgimi që ishte organizuar dhe kontrolluhej nga UCK në Llapashticë dhe gjithashtu në Majac dhe Potok, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore, duke i privuar ata nga kushtet sanitare të nevojshme dhe duke i rrahur dhe torturuar ata duke iu shkaktuar në këtë mënyrë vuajtje të mëdha dhe dhunim të shëndetit të tyre, dhe duke ua mohuar atyre të drejtën për një gjykim të drejtë; qytetarët të cilëve u është hequr në mënyrë të paligjshme liria përfshinin; dëshmitarët 7, 4, Drita Bunjakun, Agim Musliun, Idriz Svarqën, Alush Kastratin, Hetem Jasharin, dhe dëshmitarin “V”, duke patur si qëllim të planit të tyre që të detyronin personat e burgosur që të praninin tradhëtitë ndaj UÇK-së dhe të ndëshkonin ata që ishin burgosur për tradhëtitë e detyruara nga UÇK. (pika 2, 5 dhe 8).

Në një datë të panjohur, por para fundit të prillit 1999, në bashkëpunim me Rustem Mustafën dhe në pajtim me urdhërin e tij për vrasjen e Drita Bunjakut, Agim Musliut, Idriz Svarqës, të cilët në atë kohë mbaheshin të burgosur në Majac, dhe Alush Kastrati dhe Hetem Jashari që në atë kohë mbaheshin të burgosur në Potok, ai ia ka transmetuar këtë urdhër të Rustem Mustafës për vrasjen e këtyre personave pjesëtarëve të panjohur të UÇK-së dhe më pas ai vetë i ka urdhëruar këta pjesëtarë të UÇK-së që të kryejnë vrasjet të cilat ata rrejdhimisht i kanë kryer. (pika 11).

Në lidhje me Nazif Mehmetin, veprat e mëposhtme nuk janë vërtetuar:

- Pika 5 (pjesërisht) – dyshimet në lidhje me trajtimin çnjerëzor vetëm në Majac dhe Potok;
- Pika 8 (pjesërisht) – dyshimet për torturë vetëm në Majc dhe Potok;
- Pika 12 – heqja e paligjshme e lirisë në Bajgorë (Stankovic);
- Pika 13 – trajtimi çnjerëzor në Bajgorë (Stankovic);
- Pika 14 – tortura në Bajgorë (Stankovic).

**NDAJ NAIM KADRIUT**, i quajtur ndryshe “Lumi” i lindur në datën 05.03.73, vendi lindjes - Turiqec, shqiptar i Kosovës, emri i babait Halit, emri i nënës Mihane, i martuar dhe ka dy fëmijë, din shkrim dhe lexim, jeton në qytetin e Podujevës, në koordinatat gjeografike EN 1630 5062, i punësuar në Kosova Petrol, nuk ka dënime të mëparshme dhe ndaj tij nuk ka procedurë tjetër penale në zhvillim e sipër, ndodhet në paraburgim që nga 28 janari i vitit 2002;

Gjatë periudhës 31 maj 1999 deri në një datë të panjohur në mes të muajit qershor 1999, në një vend të panjohur në Koliq, në bashkëpunim më Latif Gashin, ai u ka hequr lirinë në mënyrë të paligjshme, ka rrahur dhe torturuar dëshmitarët “Q” dhe “R” duke u shkaktuar atyre vuajtje të mëdha dhe duke dhunuar shëndetin e tyre trupor, duke ua mohuar atyre të drejtën për një gjykim të drejtë (pikat 3 dhe 9).

Në lidhje me Naim Kadriun, veprat e mëposhtme nuk janë vërtetuar:  
Pika 6 – trajtimi çnjerëzor në Koliq.

**NDAJ RRUSTEM MUSTAFËS**, i quajtur ndryshe ‘Remi’, shqiptar i Kosovës, i lindur në datën 27.02.71, vendi lindjes - Perpellac, emri i babait Musli, emri i nënës Nefise, i martuar, ka kryer Fakultetin e Drejtësisë në Prishtinë, banon në qytetin e Podujevës në koordinatat gjeografike EN 1601/5245, nuk ka dënime të mëparshme dhe ndaj tij nuk ka procedurë tjetër penale në zhvillim e sipër, ndodhet në paraburgim që nga data 11 gusht 2002;

Gajtë periudhës 1 gusht 1998 deri në 26 shtator 1998, duke e ditur se disa qytetarë shqiptarë të Kosovës dhe Milan Stankovic mbaheshin të burgosur në mënyrë të paligjshme në një qendër burgimi të organizuar dhe të kontrolluar nga UÇK-ja në Bajgorë në Zonën e Llapit, dhe duke qënë në pozitën e komandantit përgjegjës për Zonën e Llapit, ai nuk ka ndëprerë burgimin e mëtejshëm të atyre personave dhe nuk ka marrë masa që t’i identifikojë dhe t’i ndëshkojë pjesëtarët e UÇK që ishin përgjegjës për ato vepra penale. (pika 1 dhe 12).

Gjatë periudhës 30 tetor 1998 deri në fund të prillit 1999, në bashkëpunim me Latif Gashin dhe i ndihmuar e përkrahur nga Nazif Mehmeti dhe të tjerët, dhe nëpërmjet një plani të përbashkët kriminal, iu ka hequr lirinë në mënyrë të paligjshme qytetarëve shqiptarë të Kosovës që dyshoheshin si bashkëpunëtorë të serbëve në një qendër burgimi që ishte organizuar dhe kontrollohej nga UCK në Llapashticë dhe në Majac dhe Potok duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore, duke i privuar ata nga kushtet sanitare të nevojshme dhe duke i rrahur dhe torturuar ata, duke i shkaktuar në këtë mënyrë vuajtje të mëdha dhe dhunim të shëndetit të tyre, dhe duke i mohuar atyre të drejtën për një gjykim të drejtë; qytetarët të cilëve u është hequr në mënyrë të paligjshme liria përfshinin; dëshmitarët 7, 4, Drita Bunjakun, Agim Musliun, Idriz Svarqen, Alush Kastratin, Hetem Jasharin, dhe dëshmitarin “V”, duke patur si qëllim të planit të tyre që t’i detyronin personat e burgosur të pranojnë tradhëtitë ndaj UÇK-së dhe të ndëshkonin ata që ishin burgosur për tradhëtitë e dyshuara nga UÇK-ja. (pika 2, 5 dhe 8).

Në një datë të panjohur ndërmjet 31 majit 1999 dhe mesit të qershorit 1999, ai ka urdhëruar Naim Kadriun që të torturojë dëshmitarin “R” duke e udhëzuar Naim Kadriun që ta detyrojë me forcë dëshmitarin “R” që të pajtohet ta kryejë një vrasje për ta siguruar për vete lirinë nga burgimi i paligjshëm në një vend të panjohur në Koliq. (pikat 3 dhe 9).

Në një datë të panjohur por para fundit të prillit 1999, ai ka urdhëruar vrasjen e Drita Bunjakut, Agim Musliut, Idriz Svarqës, që në atë kohë ishin burgosur në Majac, dhe Alush Kastratit dhe Hetem Jasharit të burgosur në Potok në atë kohë, duke e urdhëruar Nazif Mehmetin që të shkonte në Majac dhe Potok me qëllim që të siguronte që urdhëri i tij për kryerjen e këtyre vrasjeve të zbatohet nga pjesëtarët e UÇK, vrasje të cilat u kryen sipas urdhërave të dhëna nga ai. (pika 11).

Në lidhje me Rrustem Mustafën, veprat e mëposhtme nuk janë vërtetuar:  
Pika 4 – dyshimi në lidhje me trajtimin çnjerëzor (ndaj viktimave shqiptare) në Bajgorë;  
Pika 5 (pjesërisht) – dyshimet në lidhje me trajtimin çnjerëzor vetëm në Majac dhe Potok;  
Pika 6 – dyshimet në lidhje me trajtimin çnjerëzor në Koliq;

Pika 7 – dyshimet në lidhje me rrahjen dhe torturën në Bajgorë;  
Pika 8 (pjesësisht) – dyshimet në lidhje me rrahjen dhe torturën vetëm në Majac dhe Potok;  
Pika 10 – dyshimet në lidhje me vrasjen e Viktimës 1, Osman Sinani; Allegation  
Pika 13 – dyshimi në lidhje me trajtimin çnjerëzor (Stankovic) në Bajgorë;  
Pika 14 – dyshimi në lidhje me torturën (Stankovic) në Bajgorë<sup>2</sup>.

Duke i shpallur të gjithë të akuzuarit fajtorë për pika të caktuara të aktakuzës, gjyqi ua shqiptoi dënimet si në vijim:

“LATIF GASHI, për veprat penale, krime lufte, të përmendura më sipër, dënohet me 10 (DHJETË) vjet burgim.

NAZIF MEHMETI për veprat penale, krime lufte, të përmendura më sipër, dënohet me 13 (TREMBËDHJETË) vjet burgim.

NAIM KADRIU Për veprat penale, krime lufte, të përmendur më sipër, dënohet me 5 (PESË) vjet burgim.

RRUSTEM MUSTAFA për veprat penale, krime lufte, të përmendura më sipër, dënohet me 17 (SHTATËMBËDHJETË) vjet burgim.”<sup>3</sup>

#### **4. Analizë e gjykimeve:**

Seksioni për Monitorim të Sistemit Ligjor vlerësoi nëse gjykimi në fjalë ishte në pajtim me standardet për gjykim të drejtë që parashihen me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Rezultatet e vlerësimit të këtij gjykimi janë paraqitur në formë të përmbledhur në vazhdim. Sidoqoftë, është me rëndësi të ceket se analiza në fjalë ka të bëjë me çështjet procedurale të gjykimit dhe nuk mëton të vlerësojë, mbështesë, hedh poshtë gjetjet substanciale të gjykatës apo dënimet e shqiptuara nga kjo gjykatë.

##### ***i. Neni 6(1) KEDNj: E drejta për gjykim publik:***

Në bazë të nenit 6(1) KEDNj-së, “*çdokush ka të drejtë për ... gjykim publik*”

Mbajtja e seancave gjyqësore publike paraqet një parim themelor të parashikuar me të drejtën ndërkombëtare. Qëllimi i mbajtjes së seancave publike është që t’i mundësohet publikut të vështojë punën e sistemit të drejtësisë dhe së këndejmi të mbrojë palët nga ushtrimi arbitrar i pushtetit të shtetit. Kjo ndihmon në ndërtimin e besimit publik për administrimin e drejtësisë si të tërë. Ligji i zbatueshëm në Kosovë është në pajtim me këtë kërkesë. Neni 287(1) i Kodit të Procedurës Penale të Republikës Federative të Jugosllavisë parashikon se seanca kryesore duhet të mbahet me prani të publikut, dhe prania e publikut mund të përjashtohet vetëm nën rrethana të caktuara të kufizuara.<sup>4</sup>

Seancat dëgjimore në gjykimin e rastit Llapi fillimisht ishin mbajtur në një sallë të ndërtesës ku është i vendosur Këshilli Britanik (British Council). Qysh në seancën e parë të gjitha palët që ishin të pranishëm, përfshirë përfaqësuesit e shtypit, avokatin mbrojtës dhe trupin gjykues ishin të

<sup>2</sup> Lexo aktgjykimin me shkrim, faqet 1-5

<sup>3</sup> Lexo aktgjykimin me shkrim, faqet 1-5

<sup>4</sup> Neni 288 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës Federative të Jugosllavisë (KPK RFJ) lejon përjashtimin e publikut nëse një veprim i tillë është i domosdoshëm për të ruajtur sekretin, rendin dhe ligjin, mbrojtur moralin, interesat e të miturit apo interesat e veçanta të komunitetit. Lexo gjithashtu nenin 461 të KPK-së të RFJ-së përkitazi me procedurat për të mitur.

pajtimin se vendi i mbajtjes së gjykimit duhet të ndryshohet me qëllim të akomodimit të të gjithë palëve të interesuara për të ndjekur rrjedhën e gjykimit. Gjykimi mëpastaj filloi të mbahej në një vend më të madh ku të gjithë pjesëtarët e publikut ishin në gjendje të ndjekin gjykimin në të gjitha ditët, përpos në ato ditë ku seancat mbaheshin pa praninë e publikut.

Gjatë kësaj faze fillestare, çështja e lejimit të kamerave televizive në gjykatore që të filmojnë dhe transmetojnë pjesë nga seanca gjyqësore në kuadër të rrjetit të televizioneve publike u ngrit nga ana e avokatit mbrojtës. Sipas mendimit të njërit nga avokatët mbrojtës kjo do të siguronte që gjykimi të jetë publik. Gjykata shqyrtoi propozimin dhe pasi që morri parasysh pozitën e ndjeshme në të cilën mund të gjenden dëshmitarët e mundshëm, hodhi poshtë propozimin në fjalë. Megjithatë, gazetarët ishin të lejuar të ndjekin seancat publike mirëpo nuk kishin të drejtë të bëjnë fotografi.

Duke marrë parasysh faktet e sipërpërmendura, seksioni për monitorim të sistemit ligjor është e kënaqur me dozën e respektimit të të drejtës të të akuzuarit për gjykim publik. Në të vërtetë as ligji i zbatueshëm a as e drejta ndërkombëtare nuk parashikon që gjykata të lejojë kamerat televizive që të filmojnë sekuenca nga gjykimi.

**ii. Neni 6(3)(b): E drejta e të akuzuarit për kohë dhe mjete lehtësuese të duhura për të përgatitur mbrojtjen e tij/saj:**

Në bazë të nenit 6(3)(b) të KEDNj-së, një person i akuzuar për kryerje të veprës penale ka të drejtë “për kohë dhe mjete të duhura për përgatitjen e rastit të tij/saj”. Kjo e drejtë është gjithashtu e parashikuar me ligjin e zbatueshëm vendës.<sup>5</sup> Qëllimi i kësaj të drejte qëndron në faktin se i akuzuari është i gatshëm për gjykim, të përgjigjet në pohimet kundër tij/saj dhe të ndërtojë mbrojtjen e tij/saj.

Secili nga të akuzuarit, mje përjashtim të Rustem Mustafës, kanë qenë në paraburgim që nga 28 janari 2002, përderisa ky i fundit që nga 11 gushti 2002. Avokati mbrojtës, i cili i'u ishte caktuar të akuzuarve menjëherë pas arrestimit të tyre, pranoi shkresat e lëndës dhe morri pjesë në seancat hetimore. Gjykimi nuk filloi deri në shkurt të vitit 2003, 5 muaj dhe 11 muaj pas arrestimit fillestar të tyre. Ishte vërejtur se kur gjykimi filloi për herë të parë në shkurt të vitit 2003, nuk u paraqit asnjë kërkesë për të shtyer fillimin e gjykimit në baza se mbrojtja nuk është përgatitur. Së këndejmi duket se të akuzuarit kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur para fillimit të gjykimit.

Për më tepër, gjatë gjykimit, as i akuzuari dhe as avokati mbrojtës nuk kishin bërë propozim për të kërkuar më shumë kohë. Vetëm pas përfundimit të procedurës së dëshmimeve avokati mbrojtës kishte kërkuar më shumë kohë për të dorëzuar fjalimet e tyre përfundimtare. Përfundimisht, pas dëgjimit të shqetësimeve të tyre, afati për dorëzimin e argumenteve përmbyllëse u zgjat nga trupi gjykues nga ora 16:00 të martën më 8 korrik deri në 9:00 të premtën më 11 korrik.

Seksioni për Monitorim të Sistemit Ligjor është i kënaqur se ekipit të avokatëve mbrojtës i ishte ofruar kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen.

**iii. Neni 6(3)(c): E drejta për avokat mbrojtës efektiv:**

KEDNj neni 6(3)(c) garanton të drejtën e personit të akuzuar për vepër penale që të:

---

<sup>5</sup> Neni 11(3) i Kodit të Procedurës Penale të Republikës Federative të Jugosllavisë, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 26/86 (KPK RFJ-së).

*“mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij dhe kur nuk ka mjete për të shpërblyer një mbrojtës, të ndihmohet falas nga një avokat i caktuar nga gjykata kur e kërkojnë interesat e drejtësisë”.*

Avokatët mbrojtës janë të obliguar të veprojnë në interes të klientëve të tyre. Ligji i zbatueshëm obligon avokatin mbrojtës të luajë një rol aktiv gjatë procedurës për të siguruar që të drejtat dhe interesat e klientëve të mbrohen.<sup>6</sup> Gjithashtu edhe e drejta ndërkombëtare parashikon një obligim të ngjashëm për avokatin mbrojtës.<sup>7</sup>

Përkitazi me caktimin e avokatit mbrojtës gjatë gjykimit të grupit Llapi, Sistemi për Monitorim të Sistemit Ligjor ka vërejtur çështjet e paraqitura si në vijim:

- Të akuzuarit janë lejuar të zgjedhin avokatët e tyre mbrojtës të cilët janë paguar nga gjykata;
- Një person i akuzuar është përfaqësuar nga një, dy ose tre avokatë mbrojtës;
- Të akuzuarve i’u është lejuar qasja në Qendrën burimore për mbrojtje penalo-juridike<sup>8</sup> e cila qendër ka kontribuar materialisht për mbrojtjen e njërit nga të akuzuarit; dhe,
- Një i akuzuar zgjodhi “një ekspert ndërkombëtar juridik” për t’i ndihmuar avokatit mbrojtës vendës.
- Gjatë gjykimit avokatët mbrojtës për të gjithë të akuzuarit në mënyrë aktive dhe të zellshme kanë mbrojtur klientët e tyre.

Sistemi për monitorim të sistemit ligjor është i mendimit se e drejta e të akuzuarit për avokat mbrojtës efektiv ishte respektuar në mënyrë të duhur.

**iv. Neni 6(3)(d): E drejta për të thirrur dhe marrë në pyetje dëshmitarët:**

Neni 6(3)(d) i garanton personit të akuzuar për vepër penale të drejtën për:

*“të marrë në pyetje ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të kërkojë thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve që e shfajësojnë, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës”*

Në bazë të standardeve për gjykim të drejtë, mbrojtja duhet të jetë në gjendje të thirr dëshmitarët e vet dhe të testojë dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna kundër të akuzuarit, p.sh t’i ekzaminon në mënyrë të ndërsjellë këta dëshmitarë. Në përgjithësi, Sistemi për monitorim të sistemit ligjor nuk vërejt ndonjë pengesë gjatë thirrjes nga ana e avokatit mbrojtës të atyre dëshmitarëve për të cilët ata kanë menduar se janë të rëndësishëm për rastin e tyre. Më tutje, aftësia/zotësia e të akuzuarit dhe avokatit mbrojtës për të parashtruar pyetje dëshmitarëve të prokurorisë nuk ishte e penguar.

<sup>6</sup> Shih më tutje në Kodin e Etikës Profesionale për Avokatë, në pjesën me titull “Obligimet e Mbrojtjes” e cila i obligon të gjithë avokatët të këshillojnë dhe mbrojnë klientët e tyre pa vonesë, me ndërgjegje dhe zellshmëri.

<sup>7</sup> Shih më tutje parimet 13-15 të parimeve themelore mbi rolin e avokatëve të cilat parashikojnë që avokatët mbrojtës të ndihmojnë në mënyrë aktive klientët e tyre duke i këshilluar për të drejtat e tyre dhe duke i përfaqësuar në gjyq gjatë procedurës gjyqësore dhe duke i’u ofruar shërbime të cilat janë si “praktike ashtu edhe efikase”.

<sup>8</sup> Qendra burimore për mbrojtje penalo-juridike është themeluar nga Departamenti i OSBE-së për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit me qëllim të ofrimit të ndihmës dhe mjeteve për hulumtim avokatëve mbrojtës për përgatitjen e rasteve të tyre.



Disa kufizime të caktuara, sidoqoftë, përkitazi me identitetin e dëshmitarëve janë zbatuar për avanzimin e nevojës për mbrojtjen e dëshmitarit.

#### *Dëshmitarët e mbrojtur:*

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/20 mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve gjatë procedurës gjyqësore i jep pushtet trupit gjykues të përcaktojë kufizime sa i përket zbulimit të identitetit të dëshmitarit nëse konsiderohet se me zbulimin e identitetit të tij/saj dëshmitari mund të jetë objekt i dhunës fizike kundër tij apo familjes së tij.<sup>9</sup> Kjo, sidoqoftë, duhet të vihet në baraspeshë me të drejtën e të akuzuarit për të ekzaminuar në mënyrë të ndërsjellë dëshmitarët paragjykses. Më tutje në përcaktimin e besueshmërisë së një dëshmitari, është e rëndësishme që gjykata të jetë në gjendje të vlerësojë sjelljen e dëshmitarit (mënyrën se si dëshmitari duket dhe sillet gjatë marrjes së tij/saj në pyetje) – dhe në mënyrë që gjykata të jetë në gjendje t’ a bëjë këtë duhet t’ a shoh fizikisht dëshmitarin. Për këtë arsye zbatimi i masave mbrojtëse kërkon një konsideratë të kujdesshme.<sup>10</sup>

Ndërmjet 20 marsit dhe 8 majit 2003, 13 dëshmitarë të prokurorisë dëshmuan gjatë gjykimit të grupit Llapi nën masa mbrojtëse siç parashihet me rregulloren në fjalë. Këta dëshmitarë janë dëgjuar në seanca jo publike. Në pjesën më të madhe, Seksioni për monitorim të sistemit ligjor është i kënaqur se gjykata gjatë marrjes së vendimit për të urdhëruar masat mbrojtëse apo jo, baraspeshoi në mënyrë të duhur nevojën për mbrojtjen e dëshmitarit me të drejtat e të akuzuarit dhe zbatoi procedurën e duhur për këtë gjë.

Sidoqoftë, tre dëshmitarë dëshmuan në cilësi të dëshmitarit anonim nga një kabinë e vendosur në distancë ashtu që karakteristikat e tyre fizike të mos njihen nga të pranishmit në gjykatore. Mirëpo kjo gjithashtu nënkupton se trupi gjykues nuk ishte në gjendje të vështrojë sjelljen e dëshmitarëve *gjatë dhënies së dëshmvive të tyre*.<sup>11</sup> Për këtë arsye, seksioni për monitorim të sistemit ligjor është i mendimit se trupi gjykues nuk zbatoi procedurën më të përshtatshme gjatë dëgjimit të dëshmvive të dëshmitarëve anonim. Një metodë alternative, e cila do t’ju kishte mundësuar dëshmitarëve të jenë të dukshëm për trupin gjykues (mirëpo të padukshëm për publikun dhe mbrojtjen) do të ishte më e preferueshme, për shkak se kjo do t’i mundësonte trupit gjykues të vlerësojë besueshmërinë e dëshmitarëve.<sup>12</sup> Sidoqoftë, efekti negativ i kësaj parregullsie

---

<sup>9</sup> Neni 3 i rregullores parashikon që gjykata duhet të ndërmerr masa sipas nevojës gjatë gjykimit, për shembull, fshirjen e shënimeve identifikuese të dëshmitarëve nga procesverbali, deklaratat dhe dokumentet tjera, ose duke i’u mundësuar dëshmitarëve për të dëshmuar duke bërë maskimin e dukjes fizike dhe shtrembërimin e zërit. Neni 4 i rregullores i mundëson gjykatës të marrë në konsideratë mudnësinë e dhënies së anonimitetit të plotë për dëshmitarët e rrezikuar; masë kjo e cila kërkon madje edhe strehimin e dëshmitarit në një lokacion të sigurtë dhe të fshehtë madje edhe rivendosjen e tij/saj në një vend të huaj me një identitet tjetër.

<sup>10</sup> Për një diskutim të detajuar të kësaj çështje shih më tutje Shqyrtimin e OSBE-së për sistemin e drejtësisë penale (mars 2002 – prill 2003) “Mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale”, i cili mund të gjindet në faqen e internetit të OSBE-së <http://www.osce.org/kosovo>.

<sup>11</sup> Sipas mendimit tonë, fakti se trupi gjykues ka mundur të flasë – në mënyrë private apo personalisht me dëshmitarët – përkitazi me masat mbrojtëse dhe në bazë të kësaj ka mundur të shoh sjelljen e tyre në atë fazë, nuk mund të kompenzojë pamundësinë e tyre që të shohin dëshmitarët gjatë *dhënies së dëshmvive në gjyq*. Nuk ishte me rëndësi besueshmëria e frikës së dëshmitarit nga frikësimi mirëpo besueshmëria e dëshmvive të tij/saj substanciale.

<sup>12</sup> Për shembull, gjykata do të kishte mundur të dëgjojë (dhe shohë) dëshmitarin nëpërmjet të një video linku ashtu që trupi gjykues, mirëpo jo mbrojtja apo i akuzuari. Apo gjykata ka mundur të shfrytëzojë një kabinë të padukshme nga të tri anët e saj e cila do të ishte vendosur si mburojë për dëshmitarët ashtu që askush të mos i shoh përpos trupit gjykues.

procedurale është i kufizuar nga fakti se dëshmia e këtyre dëshmitarëve anonim kishte qenë e bazuar në dëshmitë që kishin dhënë dëshmitarët tjerë dhe nuk formonte bazën e vetme të provës për ndonjërin nga pikat e aktakuzës.

*Lirimi i informatave konfidenciale nga avokati mbrojtës:*

Dëshmitari i parë anonim dha dëshminë e tij/saj gjatë një séance të mbyllur (pa praninë e publikut) nga një sallë tjetër. Menjëherë pas kësaj séance të mbyllur, dy avokatët mbrojtës dhanë një përmbledhje të dëshmisë së dhënë nga dëshmitari gjatë seancës jo publike para përfaqësuesve të shtypit, e cila përmbledhje u botua mëpastaj.<sup>13</sup> Gjithashtu edhe informatat në lidhje me dëshminë e dëshmitarit të dytë i ishin raportuar mediave vendëse.<sup>14</sup>

Ekziston një shqetësim se përkundër urdhërit të gjykatës për mbajtjen e anonimitetit të dëshmitarëve në bazë të dispozitave të rregullores në fjalë dhe karakterit jo publik të seancës, avokati mbrojtës përsëri zgjedhi të informojë mediat (dhe me këtë edhe publikun) për atë se çka kanë dëgjuar nga dëshmitarët në fjalë.

## **5. Vështirësitë me dëshmitë kontradiktore:**

Gjatë ekzaminimit të dëshmimeve, Seksioni për monitorim të sistemit ligjor vërejti se një numër i dëshmitarëve të cilët kishin dhënë dëshmi fajësuese gjatë procedurës hetimore gjatë gjykimit kishin dhënë dëshmi shfajësuese. Disa dëshmitarë sugjeruan se kishin dhënë dëshmi jo korrekte gjatë hetimeve për shkak se atyre i'u është ofruar rryshfet ose për shkak se kanë qenë të kërcënuar nga zyrtarët e njësisë së hetimeve të policisë apo se madje kanë qenë të shtrënguar apo frikësuar nga gjykatësi hetues. Prokuroria konstatoi se dëshmitarët kishin ndryshuar dëshmitë e tyre për shkak të kërcënimeve apo frikësimeve nga ana e ithtarëve të të akuzuarve.

Sa i përket akuzimeve drejtuar zyrtarëve të njësisë së hetimeve të policisë se kishin ofruar mito apo kanë kërcënuar individët në fjalë me qëllim të sigurimit të dëshmimeve fajësuese, trupi gjykues thirri pesë oficerët e policisë që të dëshmojnë në gjyq përkitazi me sjelljen dhe qëndrimin e tyre gjatë hetimeve për rastin Llapi. Gjatë dëshmimeve të tyre më 24, 25 qershor dhe 1 korrik, si të akuzuarit ashtu edhe avokatët e tyre mbrojtës ishin lejuar t'ju parashtronjë pyetje hetuesve në fjalë pas marrjes së gjatë në pyetje nga ana e trupit gjykues.

Sa i përket çështjes së animimit të mundshëm të gjyqtarit hetues gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve, trupi gjykues morri parasysh këtë çështje gjatë përpilimit të aktgjykimit të shkruar. Gjykata konstatoi se “kishte studiuar me kujdes përgjigjet e dëshmitarëve të dhëna para gjyqtarit hetues për të përcaktuar ndikimin që sjellja dhe qëndrimi i gjyqtarit hetues do të kishte mundur të ketë në saktësinë e përgjigjeve të dhëna nga këta dëshmitarë” dhe përfundoi se “një studim i tillë i mundësoi trupit gjykues të dalë më pikëpamjen e vet se jo të gjitha gjërat që janë thënë nga ana e dëshmitarëve para gjyqtarit hetues mund të merren si të pabesueshme, siç ishte përmendur në rastin e dëshmitarit ‘K’”.<sup>15</sup>

<sup>13</sup> “Dëshmitari Nr. 4 mohoi çdo gjë çka kishte pohuar gjatë hetimeve duke thënë se kishte qenë nën presion të policisë së UNMIK-ut dhe se atij i ishte premtuar një shumë e madhe e të hollave [...]” nga artikulli ‘A ka qenë dëshmitari numër katër i kërcënuar nga policia e UNMIK-ut’ Kosova Sot, 21 mars 2003 (përkthim jozyrtar).

<sup>14</sup> Epoka e Re, 1 prill 2003, “Dëshmitari i dytë gjithashtu flet për skandalin e madh gjatë hetimeve.”

<sup>15</sup> Lexo aktgjykimin me shkrim në faqen 55, fusnota 130.

Seksioni për monitorim të sistemit ligjor është i kënaqur me procedurat të cilave gjykata i'u është përbajtur përkitazi me këto çështje.

## 6. Reagimet pas gjykimit:

Që nga fillimi, rasti Llapi kishte qenë me interes medial dhe politik. Seksioni për monitorim të sistemit ligjor ka qenë i shqetësuar veçanërisht me artikullin e botuar në gazetën Koha Ditore më 8 gusht 2003 me titull "*Pse gjykimi i Remit është politizuar*", e cila për autor kishte gjyqtarin hetues të rastit në fjalë. Artikulli i cili përmbante pikëpamjet e gjyqtarit hetues në lidhje me aspektet e ndryshme të këtij rasti, ishte botuar pa marrë parasysh se aktgjykimi ishte shpallur dhe përkundër faktit se palët do të kishin pasur mundësi të parashtronë ankesë kundër vendimit të marrë. Ky artikull nxiti edhe botimin e një sërë artikujsh tjerë gazetaresk që kishin të bëjnë me këtë rast për shkak se madje edhe njëri nga avokatët mbrojtës kishte botuar një përgjigje të tij ndaj artikullit të botuar nga gjyqtari hetues, me titull "Ekzistojnë 8 arsye për shkak të cilave kosovarët nuk kanë besim në gjyqtarët ndërkombëtar" (Koha Ditore, 12 gusht). Ky shkëmbim sarkastik dhe publik i pikëpamjeve ndërmjet ndërmjet gjyqtarit ndërkombëtar hetues dhe avokatit mbrojtës përkitazi me këtë rast mjaft të ndjeshëm (në të cilin rast të dy këta kishin punuar) mund të dëmtojë dinjitetin e gjykatës. Seksioni për monitorim të sistemit ligjor pajtohet me trupin gjykues të cilët konsideruan se artikujt e tillë gazetaresk "nuk janë një gjë e mirë."<sup>16</sup>

Për më tepër, komentet e dhëna nga ana e disa anëtarëve të parlamentit në fazën pas shpalljes së aktgjykimit nuk i ndihmuan gjendjes së krijuar fare. Seksioni për monitorim të sistemit ligjor vështroi gjithashtu *citatin e botuar në media të deklaratës së ushtruesit të detyrës së kryeministrit në atë kohë i cili tha "Gjykatat kosovare janë të motivuara politikisht dhe ato janë të dëmshme për të ardhmen e Kosovës. Njerëzit të cilët i kanë shërbyer regjimit serb janë duke i fabrikuar këto gjykime"* dhe komentet tjera të ngashme emotive të dhëna nga anëtarë tjerë të parlamentit. Një sentimentalizëm i tillë i pabazuar ka gjasa të minojë besimin e publikut në gjyqësi.

## 7. Përfundim:

Sistemi për monitorim të sistemit ligjor është i kënaqur me mbarëvajtjen e procedurës. Trupi gjykues ka bërë përpjekje të tilla për të siguruar që gjykimi është duke u zhvilluar në mënyrë të drejtë dhe që të gjitha çështjet që ngriten nga palët në procedurë të dëgjohen dhe konsiderohen me kujdes. Në asnjë moment të drejtat e të akuzuarit nuk janë cunuar në mënyrë serioze.

---

<sup>16</sup> Lexo aktgjykimin me shkrim në faqen 55 fusnota 130.